

Koha së bashku

Aktivite argëtuese dhe të thjeshta që
mund t'i bëni në shtëpi me fëmijën tuaj

National
Literacy
Trust

Change your story

Mirë se vini

Të flisni me fëmijën tuaj dhe të ndani libra me ta bën që ata ta nisin më së miri jetën e tyre.

Si prind, ju keni një rol të veçantë. Lajmi i mirë është se nuk ka nevojë të jeni ekspert që ta ndihmoni fëmijën të jetë gati të mësojë.

A e dini se fëmijët mësojnë shumë falë eksperiencave të thjeshta e të përditshme me ju?



Këshilla të mira

Këshillat e mira në këtë libër japin sugjerime se si mund ta ndihmoni fëmijën tuaj të mësojë dhe të përgatitet për shkollë.

Fjalë për aktivitetet e jetës

Përdorni fjalët për aktivitetet e jetës për ta ndihmuar fëmijën të fitojë aftësitë gjuhësore që do t'i duhen në shkollë.

Për të filluar, provoni këto gjëra. Mund të gjeni më shumë ide online në **[wordsforlife.org.uk](https://www.wordsforlife.org.uk)**.

Këshillë e mirë

Fëmijës suaj i pëlqen shumë kur i thoni "të lumtë"! Lavdërimet e shumta e bëjnë fëmijën të ndihet i kënaqur me veten.



Fjalë për aktivitetet e jetës

Bisedoni me fëmijën tuaj kur dilni jashtë – kur ecni në rrugë, kur udhëtoni me autobus, kudo që të jeni! Ata mund të mësojnë shumë fjalë të reja nga ju.



Bisedoni, luani, lexoni

Bisedat kanë rëndësi!

Flisni me radhë dhe dëgjojeni fëmijën.

Fëmijët mësojnë duke bërë pyetje, duke folur për idetë e tyre, duke treguar se çfarë shohin dhe duke folur me zë me vete.

Kur bisedoni me fëmijën tuaj, mund të argëtoheni së bashku. Proveni:

- të bëni pyetje
- të flisni për eksperiencat e përditshme
- të bëni shaka
- të bëni budallallëqe
- të luani
- të këndoni



Këshillë e mirë

Për më shumë ide vizitoni
[wordsforlife.org.uk](https://www.wordsforlife.org.uk)

A e dinit se sa më shumë të flisni me fëmijën dhe sa më shumë fjalë të dëgjojnë prej jush, aq më shumë do të mësojnë në shkollë në moshën 10 vjeç?



Fjalë për aktivitetet e jetës

Bisedoni me fëmijën në lidhje me atë që po bëni, teksa bëni punët e përditshme, si për shembull kur palosni rrobat ose kur përgatitni darkën.

Këshillë e mirë

Nëse luajtja është shumë e gjallë ose shumë e zhurmshme, shkoni te parku pranë!

Fjalë për aktivitetet e jetës

Tregojni historinë ‘*Do të shkojmë për të gjuajtur arin*’ dhe më pas filloni të gjuani në mënyrë imagjinare arinjtë në lulishten ose parkun afër!

Fjalë për aktivitetet e jetës

Merrni pjesë dhe luani rolin gjatë lojës imagjinare të fëmijës! Bëjuni pyetje si personazh ose përshkruani se çfarë po bën fëmija. Kjo mund t’i japë mundësi fëmijës të dëgjojë fjalë të reja dhe të zgjidhë probleme.



Luani

Fëmijët mësojnë ta njohin botës duke luajtur!

Luajtja është diçka shumë e rëndësishme për rritjen e fëmijëve. Luajtja me fëmijët i ndihmon ata të mësojnë të komunikojnë, të respektojnë radhën e tjetrit, të ndajnë gjërat me të tjerët dhe të bëjnë miq.

Fëmijët kënaqen kur përdorim imagjinatën për t’i kthyer objektet e ndryshme në gjëra për të luajtur. Mund t’u jepni gjëra për të veshur, si për shembull këpucë për të rritur, rroba, çanta e madje kontejnerë bosh – kutitë e mëdha janë shumë të mira!

A e dinit se kur i jepni mundësi fëmijës të zgjedhë se me çfarë ka dëshirë të luajë, e bën të jetë më i pavarur dhe e ndihmon të jetë gati për shkollën?





Leximi i tabelave

Printimi është kudo!

Fëmijët jetojnë në një botë plot me mesazhe të shtypura dhe që shihen, figura dhe logo të cilat gjenden kudo.

Të dallojnë vendin e tyre të preferuar ku hanë ose emrin e supermarketit janë hapat e parë që të mësojnë të lexojnë e të shkruajnë.

A e dinit se sa më shumë sheh dhe lexon fëmija juaj, aq më shumë ka të ngjarë që të ketë dëshirë të lexojë!

Këshillë e mirë

Sigurohuni që fëmija t'ju shohë teksta kënaqeni duke lexuar, si për shembull libra, revista, manuale, receta ose udhëzime, dhe tregojini pse po lexoni.

Fjalë për aktivitetet e jetës

Kur keni dalë me fëmijën tuaj, shikoni tabelat, simbolet, logot dhe fjalët përreth jush. Nxiteni që t'ju tregojë ato dhe ndihmojeni që t'i "lexojë" ato që nuk i kupton!



Hani, flini, lëvizni

Ushqeni trupin që po rritet të fëmijës!

Një dietë e përzier dhe e shumëllojshme me fruta e perime të freskëta dhe bulmet është e rëndësishme për ta ndihmuar trupin dhe kockat të rriten shëndetshëm. Gatimi mund të jetë më i lirë se blerja e ushqimeve të gatshme. Ushqimet e thara ose të konservuara, si makaronat, domatet dhe fasulet janë të mira, ushqime dollapi me të cilat mund të bëhen shumë gatime të ndryshme.

A e dinit se shumë supermarketë kanë receta të shkëlqyera për gatime që nuk janë shumë të shtrenjta? Ose mund të kërkontë në internet ide të tjera: nhs.uk/start-for-life/baby/recipes-and-meal-ideas

Fjalë për aktivitetet e jetës

Përfshijeni edhe fëmijën ndërsa gatuar, duke i treguar se çfarë po bëni.



Këshillë e mirë

Pyesni miqtë se çfarë u pëlqen të hanë fëmijët e tyre, dhe shkëmbeni recetat!

Këshillë e mirë

Pyesni shkollën e fëmijës se çfarë mund të hajë fëmija në mëngjes dhe në drekë!

Flini mirë

Çlodhuni dhe relaksohuni!

Gjumi dhe pushimi i mjaftueshëm janë shumë të rëndësishëm për fëmijët, pasi ata rriten dhe zhvillohen gjatë gjithë kohës.

Programi i gjumit

Programi i gjumit mund të jetë kështu:

- 6.45 pasdite: vendosja e pizhameve, larja e dhëmbëve, vajtja në banjë.
- 7.15 e pasdites: orar i qetë duke lexuar libër, tregime ose biseda të qeta.
- 7.30 e pasdites: natën e mirë dhe fik dritat!

A e dinit se këngët e qeta dhe ninullat mund t'i qetësojnë fëmijët dhe mund t'i ndihmojnë t'i zërë gjumi?



Këshillë e mirë

Përpikuni të pakësoni kohën e qëndrimit në ekran në telefona, televizorë ose kompjuterë para gjumit, pasi kjo mund t'ua bëjë të vështirë fëmijëve që të flenë.

Për sugjerime se si ta ndihmoni fëmijën që të flejë, vizitoni **sleepfoundation.org**

Fjalë për aktivitetet e jetës

Në vend t'i lexoni libër para se të flejë, përpikuni të sajoni një histori duke përdorur imagjinatën tuaj!





Lëvizni

Është koha të jeni aktivë fizikisht!

Rekomandohet që fëmijët e moshës deri në pesë vjeç të kenë tri orë aktiviteti fizik në momente të ndryshme gjatë ditës². Disa aktivitete të tilla janë ecja, kërcimi, vrapi, ngjitja dhe mbajtja e ekuilibrit. Trupi i fëmijëve rritet dhe zhvillohet shpejt gjatë kësaj kohe. Fëmijëve u pëlqen të jenë aktivë, dhe ata kanë nevojë të lëvizin që të jenë mirë dhe të kenë shëndet.

Këshillë e mirë

Gjeni një aktivitet fizik që ju pëlqen (ndoshta të kërceni me muzikë ose të vraponi) dhe nxiteni fëmijën që të bashkohet me ju!

Fjalë për aktivitetet e jetës

Kërkojini fëmijës që t'ju tregojë diçka që ka bërë kur ishte në kopsht. Pyete se çfarë i pëlqente dhe çfarë nuk i pëlqente, dhe pse.



Disa nga aktivitetet për shumicën e fëmijëve që mund të ecin vetë janë:

- Loja aktive (si kukafshehtas, ose bllokimi në baltë)
- Vrap
- Kërcimi në trampolinë
- Xhirot me biçikletë
- Kërcimi
- Noti
- Kërcimi me litar
- Gjymnastika³

Çfarë mund të bëni për ta ndihmuar fëmijën

Studimet tregojnë se ka shtatë gjëra që prindërit mund të bëjnë me fëmijët e tyre për t'i ndihmuar që të mësojnë dhe të arrijnë rezultate të mira në jetë⁴.

Ndani libra dhe tregime

Shikimi i librave së bashku është një mënyrë e shkëlqyer për të mësuar në moshë shumë të njomë.

Këndoni këngë dhe recitoni

Recitimi i vjershave dhe këndimi i këngëve të kopshtit është një mënyrë e shkëlqyer për ta ndihmuar fëmijën të mësojë tinguj dhe fjalë të reja me anë të rimës dhe përsëritjes.

Dilni jashtë

Kur dilni së bashku për shëtitje ose për të shkuar në dyqan, keni mundësi që ju dhe fëmija juaj të provoni gjëra të reja, si për shembull gjëra për të parë, ndjerë, shijuar, nuhatur dhe dëgjuar, si edhe shumë gjëra për të cilat mund të bisedoni!

Luani së bashku

Fëmijët e vegjël mësojnë duke luajtur. Luajtja së bashku i ndihmon fëmijët të zhvillojnë aftësitë që u duhen për të komunikuar dhe për t'u socializuar me të tjerët.

Luani me shkronja

Luajtja e lojërave me format dhe tingujt e shkronjave e bën mësimin argëtues.

Këto aktivitete

të thjeshta janë vërtet shumë të rëndësishme për sa i përket mënyrës se si fëmija mëson dhe zhvillon aftësinë për të dëgjuar, folur, lexuar dhe shkruar. Mund të argëtoheni së bashku dhe njëkohësisht të përgatiteni për shkollë!

Pikturoni dhe vizatoni

Bërja e shenjave dhe shkarravinave janë fillimi i mësimit për të shkruar.

Qasja në libra

Nëse ka bibliotekë të hapur pranë, mund të merrni libra falas dhe të ndiqni aktivitete falas për fëmijë. Kopshtet pranë, qendrat për fëmijët dhe shkollat mund të kenë libra falas. Vetëm duhet të kërkon!





Tregimet

Nuk është e nevojshme që të lexoni gjithnjë. Shikimi i figurave në libra dhe diskutimi për to është një mënyrë e shkëlqyer për ta nxitur fëmijën të kënaqet me tregimet. Nëse në shtëpi flisni gjuhë tjetër, flisni për figurat dhe tregimin në gjuhën tuaj.

Kur shikoni librat së bashku, mund të argëtoheni shumë:

- Flisni për kapakun e librit dhe tregoni me gisht titullin.
- Jepini mundësi fëmijës ta mbajë librin dhe të kthejë faqet.
- Nxiteni që të flasë për figurat.
- Ndryshoni zërin sipas personazheve. Shtoni efekte zëri, si përplasja e ujit në pellg, boritë e makinave ose zhurmat e kafshëve.
- Kur tregimi ka mbaruar, mund ta pyesni nëse i ka pëlqyer dhe nëse i pëlqen ndonjë personazh.

Këshillë e mirë

Bëni një çerdhe së bashku (një mbulesë sipër tavolinës), ku ka hapësirë për të dy. Mund ta bëni çerdhen pjesë të tregimit – mund të jetë një shpellë gjigantësh, një anije kozmike ose një kullë princeshe.

A e dinit se fëmijët, të cilëve prindërit u kanë lexuar rregullisht në moshën pesë vjeç, kanë pasur rezultate më të mira në testimet e matematikës, fjalorit dhe shqiptimit në moshën 16 vjeç sesa fëmijët që nuk e kanë marrë këtë lloj ndihme?⁵

A e dinit se fëmijët që shpesh kanë një këngë të preferuar, duan ta dëgjojnë pa pushim? Kjo i ndihmon që të mësojnë radhën e fjalëve dhe t'i lidhin fjalët e shkruara në tregim – të cilët janë hapat e parë për të mësuar për të lexuar!

Fjalë për aktivitetet e jetës

Flisni me fëmijën tuaj për atë që keni bërë ju kur ishit fëmijë Përfshini të gjithë familjen – gjyshërit mund të kenë histori për të treguar kur kohën kur ishin vetë fëmijë!



Këndimi i këngëve dhe recitimi i vjershave

Këngët dhe vjershat zhvillojnë të folurit dhe fjalorin e fëmijës, si edhe lëvizjet dhe koordinimin nëse ato përfshijnë veprime. Shumë prej tyre i ndihmojnë që të mësojnë të numërojnë.

Mos u shqetësoni nëse zëri nuk keni zë të mirë ose të intonuar. Kjo nuk është e rëndësishme, dhe sa më shumë që të këndonni me fëmijën tuaj, aq më shumë do të krijoni vetëbesim.

Nëse nuk e dini melodinë, mund të merrni borxh CD me vjersha në bibliotekë ose mund t'i kërkontë në YouTube. Mund të krijoni edhe këngët tuaja, ose t'i këndonni në radio së bashku.

A e dini se këngët dhe vjershat mund ta ndihmojnë fëmijën të mësojë rreth botës? Mund të bëni zhurmat e kafshëve në "Plaku Mekdonald kishte një fermë" dhe të numëroni peshqit në "1, 2, 3, 4, 5 një herë kapa një peshk të gjallë"!

wordsoforlife.org.uk/themes/songs-and-rhymes





Këshillë e mirë

Nëse dini këngë ose vjershë të tjera në gjuhë tjetër, këndojini dhe recitojini edhe ato me fëmijën.

Merimanga insi-uinsi


Aktroni sipas këngës teksa e këndoni ose krijoni merimangën dhe tubin tuaj së bashku duke përdorur gjëra të tilla si, gotat e kosit, lesh dhe letra kuzhine. Mund të gjeni një video të këngës me veprime: [wordsforlife.org.uk/activities/incy-wincy-spider](https://www.wordsforlife.org.uk/activities/incy-wincy-spider)

Merimanga insi-uinsi u ngjit te ulluku i çatisë

Por ra shiu dhe e hodhi merimangën poshtë

Pastaj doli dielli dhe e thau gjithë shiun

Dhe merimanga insi-uinsi u ngjit te ulluku përsëri



Luani së bashku

Të mësosh t'i ndash gjërat me të tjerët, të respektosh radhën, të ndihesh rehat me të tjerët dhe të bësh miq janë aftësi që nevojiten në jetë, por mund të duhet kohë për t'i mësuar! Mund ta ndihmoni fëmijën të mësojë t'i praktikojë këto aftësi të rëndësishme duke luajtur së bashku, ose duke caktuar data për të luajtur me miqtë ose pjesëtarët e familjes, qoftë ballë për ballë, qoftë me FaceTime ose WhatsApp.

Këshillë e mirë

Të gjithë fëmijët janë të ndryshëm! Disa janë më të gjallë dhe më me vetëbesim se të tjerët – ndaj mos i krahasoni dhe mos u shqetësoni – ju e njihni fëmijën më mirë nga kushdo tjetër, prandaj jepini ndihmën dhe nxitjen që i duhet.



A e dinit se të mësosh të luash me të tjerët është shumë e rëndësishme për zhvillimin personal, social dhe emocional të fëmijëve? Mund të bëheni një shok shumë i mirë loje për fëmijën tuaj.

Thjesht ndiqni interesat e fëmijës!

Fëmijët luajnë në shumë mënyra të ndryshme:

- luajnë vetëm
- shohin kur fëmijët e tjerë luajnë
- luajnë bashkë me të tjerët; bëjnë të njëjtin aktivitet, por nuk bashkohen me të tjerët
- shfaqin më shumë interes në atë që bëjnë të tjerët dhe fillojnë të bisedojnë së bashku
- luajnë së bashku, zakonisht në grup të vogël



Këshillë e mirë

Nxiteni dhe jepini zemër fëmijës që të krijojë besim te vetja ndërsa fillon të bëjë miqtë e tij.

Luani me shkronja dhe numra

Ka shumë lloje lojërash me shkronja dhe numra që mund të luani, që nga forma e tingulli i tyre deri te mësimi i fjalëve të reja që e kanë të njëjtë shkronjën e parë. Mund të mendoni për numra që fëmija juaj i njeh, si numri i derës ose moshës së tyre, dhe të shihni nëse mund t'i gjeni këta numra në autobusë, dyqane ose tabela rrugore. Kini parasysh se shkronjat dhe numrat gjenden kudo!

Këshillë e mirë

Numëroni me zë bashkë me fëmijën – gjeni sa hapa ju duhen për të arritur te dera ose sa shtylla dritash kaloni derisa të arrini te parku!

Fjalë për aktivitetet e jetës

Flisni për shkronjat që mund të gjeni te letrat e parëndësishme dhe te revistat e vjetra. Pritini shkronjat dhe bëni një kolazh. Shikoni nëse mund të gjeni shkronjën e parë të emrit të fëmijës. Nëse nuk ai e gjen dot shkronjën akoma, vizatojeni së bashku dhe shikoni nëse ai mund ta gjejë kur të dilni jashtë.



"Do të shkoj në park"

Luani një lojë duke thënë me radhë se çfarë do të merrni me vete kur të shkoni në park. Rregulli është se mund të merrni me vete vetëm gjërat që fillojnë me tingullin "p" (për shembull, "Do të shkoj në park dhe do të marr një pemë/patate/pulë (picnic/parrot/pencil)"). Mund të argëtoheni më shumë duke e ndryshuar vendin ku po shkoni (për shembull, në bregdet, ku mund të merrni me vete vetëm gjëra që fillojnë me "s"). A mund të mbani mend çdo gjë që do të merrni me vete?

Shkronja me plastelinë ose brumë

Provoni të krijoni së bashku shkronja duke përdorur plastelinë, ose bëni pak brumë.

Bashkoni:

- dy gota miell
- $\frac{1}{2}$ ujë të ftohtë
- tre lugë gjelle vaji vegjetal
- një lugë gjelle lëngu limoni (opsional)
- ngjyrues ushqimi ose xixa sipas dëshirës.



Fjalë për aktivitetet e jetës

Për ta nxitur fëmijën që të mësojë të lexojë, përdorni tingujt e shkronjave në vend se emrat e shkronjave në alfabet. Përdorimi i tingujve të shkronjave kur luani së bashku lojëra, si "Do të shkoj në park" ose "Unë spiunoj", do t'i ndihmojë të thotë tingujt e fjalëve ndërsa mëson për të lexuar.





Dilni jashtë

Bota është plot me fjalë dhe figura të bukura dhe plot me gjëra për të bërë, për të provuar e për të eksploruar, duke filluar nga paketat e cerealeve dhe tabelat e rrugëve, deri te pellgjet me ujë dhe gjethet e rëna.

Nxiteni fëmijën që të eksplorojë botën.

- Bëni një shëtitje dhe flisni për shkronjat, fjalët dhe numrat në tabelat e rrugës dhe reklammat e dyqaneve
- Kur blini ushqime, krahasoni madhësitë, ngjyrat dhe aromat e frutave dhe perimeve

A e dini? **se** shëtitja e ndihmon fëmijën të mësojë. Ecni me ritmin e fëmijës, bisedoni dhe tregoni interes në gjërat që ata vërejnë dhe pyesin.

Si të bëni varëse çelësash me figura

Çfarë ju duhet

- laps dhe letër për listën e pazarit
- figura të frutave dhe perimeve
- gërshërë të parrezikshme për fëmijët
- shpuese vrimash
- spango ose fjongo për të kaluar figurat

Çfarë të bëni

Gjeni një recetë dhe bëni së bashku listën e pazarit duke prerë figura të ingredientëve nga fletëpalosjet dhe revistat.

Bëni një varëse çelësash duke shpuar një vrimë në secilin cep të figurës dhe duke i lidhur së bashku me spango.

Jepiani fëmijës ta mbajë varësen e çelësave kur bëni pazarin. Kjo do ta ndihmojë që t'i gjejë ushqimet duke përdorur figurat. Flisni së bashku në lidhje me gjërat që shihni dhe numëroni së bashku se sa copë ju duhen.

Këshillë e mirë

Varëset e çelësave me figura janë një mënyrë e shkëlqyer për të luajtur me fëmijën. Proveni të bëni një varëse çelësash me figura që mund të shihni kur jeni jashtë.

Fialë për aktivitetet e jetës

Kur jeni jashtë me fëmijën, dëgjoni zhurmata e mundshme, si zhurmata e makinave, sirenat, muzikë, të lehurat e qenve, zogjtë që këndojnë dhe avionët.

Flisni për atë çka dëgjoni.

Proveni t'i imitoni zhurmata – a bën dot edhe ti kështu?





Qasja në libra

Shkolla, biblioteka, qendra për fëmijët ose kopshti pranë mund t'ju ndihmojnë të merrni libra falas për fëmijë. Telefononi dhe pyesni!

Nëse biblioteka është e hapur, mund të merrni libra falas!

A e dinit se sa më shumë libra për fëmijë të keni në shtëpi, aq më shumë ka të ngjarë që fëmija të mësojnë në shkollë? Nuk është medemos e nevojshme që të jenë librat tuaj – në fakt, sa më shumë libra të jenë marrë borxh, aq më mirë është⁶.

Këshillë e mirë

Mbajini në vend të volitshëm librat për fëmijë të bibliotekës në mënyrë që fëmija t'i shohë kur të ketë dëshirë. Ose, pse të mos i mbani librat për fëmijë bashkë me lodrat e tij? Edhe arushave dhe kukullave u pëlqen të lexojnë!

Fjalë për aktivitetet e jetës

Edhe revistat janë shumë të bukura për t'i parë së bashku. Flisni për figurat e ndryshme dhe pyeteni fëmijën se çfarë i pëlqen më shumë.



Gjetja e librit të duhur

Ka më shumë të ngjarë që fëmija të ketë dëshirë ta shohë librin bashkë me ju nëse e ka zgjedhur vetë. Ja disa mënyra se si mund ta ndihmoni të zgjedhë një libër që do t'i pëlqejë:

- **Shikoni kapakun**
A mund të gjejë libra që flasin për gjëra që i pëlqejnë?
- **Zhytuni!**
Hidhini një sy brenda. A i pëlqejnë figurat?
- **A ka personazhe që i pëlqejnë?**
A ka monstra ose arusha tedi ose alienë ose trenat?
- **A mund të bëjë ndonjëri nga ju zhurma sipas figurave?**
Zhurmat e kafshëve, makinave, trenave ose raketave.
- **A është histori me aksion?**
A i pëlqen të përfshihet me këto lloj tregimesh?
- **A ka surpriza?**
A i pëlqejnë librat me figura pop-up ose me skeda për t'i kthyer? A mund të gjeni personazhin e fshehur?

Argëtohuni duke pikturuar dhe vizatuar



Piktura dhe vizatimi e ndihmon fëmijën të rritë përqendrimin, kreativitetin dhe aftësitë që i duhen për të shkruar.

Përdorni materiale të ndryshme për të shkruar, si shumësja, lapsa, shumës rroje dhe bojë. Është shumë argëtuese të përdorni ujë dhe një furçë mbi gurët e pllakat e trotuarit në kopsht.

Këshillë e mirë

Bëhuni kreativ. Nxiteni fëmijën të bëjë shenja, të vizatojë dhe të ngjijë figurat që janë bërë me objekte të ndryshme, si pupla, guaska ose kleçka.

Pritni figurat e preferuara nga revistat dhe bëni kolazhe.

Si të bëni librin tuaj të kujtimeve

Çfarë ju duhet

- Një libër shënimesh
- Stilolapsa, lapsa me ngjyra dhe lapsa të thjeshtë
- Fotografi
- Revista dhe katalogë
- gërshtë të parrezikshme për fëmijët
- Ngjytës

Çfarë të bëni

- Ndihmojeni fëmijën të zbukurojë kapakun e librit të kujtimeve Shkruani së bashku emrin e tij.
- Shtoni fjalë ose vizatime të gjërave të tyre të preferuara, si ushqime, vende ose lodra, ose foto të familjarëve ose kafshëve tuaja shtëpiake.
- Mblidhni biletat e autobusit dhe biletat e tjera kur dilni dhe lëreni fëmijën që t'i ngjijtë.
- Proveni ta lejoni fëmijën të përdorë xixa, bojë, ngjytës ose çdo gjë tjetër për ta bërë librin e kujtimeve argëtues dhe plot me ngjyra.

Fjalë për aktivitetet e jetës

Flisni për vizatimet e fëmijës suaj dhe pyeteni se çfarë ka vizatuar. Zgjidhni forma dhe pamje që mund të dallohen dhe vizatoni vetë disa prej tyre.



Përgatitja për shkollën

Mund ta përgatitni fëmijën për shkollën:

- duke luajtur lojëra që përfshijnë respektimin e radhës dhe ndarjen e gjërave me të tjerët
- duke i ndihmuar që të kërkojnë se çfarë u duhet, nëse kanë uri, kanë etje ose janë të lodhur.
- duke i mësuar si të vishen vetë, të hanë vetë dhe ta përdorin tualetin vetë.

Vajta në shkollë mund të jetë eksperiencë e këndshme për të gjithë

- Si prind, ju jeni mësuesi i parë i fëmijës suaj.
- Merrni informacion për shkollën, që të kuptoni se çfarë do të ndodhë kur fëmija të fillojë shkollën.
- Nëse mësuesi i shkollës ju thotë se do t'ju bëjë një vizitë në shtëpi para se të fillojë shkolla, pranojeni.
- Vizitoni faqen e internetit të shkollës.

Sigurohuni që të dini se çfarë duhet të bëni ditën e parë: ku të shkoni në mëngjes dhe ku ta merrni fëmijën.



A e dinit se sa më parë të njihen fëmijët me shkollën ose kopshtin, aq më të lehtë e kanë të përshtaten?

Lexoni libra për ditën e parë të shkollës

Ka shumë libra të ndryshëm që mund të shihni së bashku në lidhje me shkollën. Kjo mund ta ndihmojë fëmijën të ndihet i përgatitur për të filluar ose për t'u kthyer në shkollë.

Më poshtë janë renditur disa libra:

- *Starting School* nga Janet dhe Allen Ahlberg
- *Topsy and Tim Start School* nga Jean dhe Gareth Adamson
- *Going to School* nga Anna Ciardi dhe Stephen Cartwright
- *Harry and the Dinosaurs Go To School* nga Ian Whybrow
- *Come to School Too, Blue Kangaroo!* nga Emma Chichester Clark
- *I Am Too Absolutely Small For School* nga Lauren Child

Vënia në praktikë e zakoneve të reja

Praktikoni zakonet e mëngjesit, si zgjimi dhe veshja, ngrënia e mëngjesit "kur është koha për të shkuar në shkollë". Sigurohuni që fëmija të flejë mjaftueshëm dhe të jetë gati për ditën e parë të shkollës.

Këshillë e mirë

Në fund të ditës, përshëndeteni fëmijën me një buzëqeshje dhe jo me celular!

Fjalë për aktivitetet e jetës

Shikoni një prej librave të mësipërm.
Flisni për mënyrën si ndihet fëmija për vajtjen në shkollë.



**National
Literacy
Trust**

Change your story

T: 020 7587 1842

E: contact@literacytrust.org.uk

W: literacytrust.org.uk



Na gjeni në Facebook: facebook.com/nationalliteracytrust



Na ndiqni në Twitter: [@Literacy_Trust](https://twitter.com/Literacy_Trust)



Na ndiqni në Instagram: [@Literacy_Trust](https://www.instagram.com/Literacy_Trust)



Regjistrohuni për Newsletter tonë falas me email:
literacytrust.org.uk/newsletter

National Literacy Trust është një organizatë bamirësie e regjistruar me nr. 1116260 dhe një kompani e kufizuar me garancinë nr. 5836486 e regjistruar në Angli dhe Uells, dhe organizatë bamirësie e regjistruar në Skoci me nr. SC042944. Adresa e regjistruar: 68 South Lambeth Road, London SW8 1RL.

Patron: HRH The Duchess of Cornwall

© National Literacy Trust 2023. Ky burim "Të gjithë gati për në shkollë" është licencuar sipas Open Government Licence 3.0.

Referenca:

1. <https://raisingchildren.net.au/school-age/sleep/understanding-sleep/school-age-sleep>
2. <https://www.gov.uk/government/publications/uk-physical-activity-guidelines>
3. <https://www.nhs.uk/live-well/exercise/physical-activity-guidelines-children-under-five-years/>
4. Effective Preschool, Primary and Secondary Education (EPPSE). Kathy Sylva et al
5. Social inequalities in cognitive scores at age 16: The role of reading. Alice Sullivan, Matt Brown, 20136.
6. Parent's perspectives: Children's use of technology in the Early Years, Dr Susie Formby, National Literacy Trust, 2014